



Universiteti i Elbasanit në "Panairi Work&Study 2023"

Personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mirëpriti në Panairin Work&Study 2023, zhvilluar në Pallatin e Sportit, maturan të shumë të cilët u informuan mbi programet e studimit që ofrohen, mundësitë e financimit për regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve, praktikat profesionale, programet e shkëmbimit studentor dhe hapësirat e dedikuara për zhvillimin e tyre shkencor, profesional e kulturor. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të këshillimit të karrierës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, IAL, Dhomën e Tregtisë Tiranë, ZVA Elbasan dhe Bashkinë Elbasan.

Ambasadorja e Suedisë në Shqipëri Znj. Elsa Håstad



Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit, mirëpriti në një takim zyrtar Ambasadorën e Suedisë në Shqipëri, Znj. Elsa Håstad. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimet e deritanishme dhe urat e bashkëpunimit në të ardhmen me institucionet e arsimit të lartë në Suedi, si edhe me institucionet e tjera partnere. Ky takim u zhvillua në kuadër të Tryezës së 8-të të Rrumbullakët e Çështjeve Gjimore me temë "Aktivizmi i grave për barazi gjinore", organizuar në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhëve të Huaja. Znj. Håstad së bashku me Z. Michele Ribotta, përfaqësues i UN Women në Shqipëri dhe Znj. Mirela Gjoni e Forumit të Gruas Elbasan, diskutuan me studentët mbi fuqizimin e zërit të grave në shoqëri, pjesëmarrjen më të gjerë të tyre në sfera të ndryshme të shoqërisë.

Akademikë të huaj në UE



Si pjesë e strategjisë së UE-së, për promovimin e standardeve më të larta të cilësisë së mësimdhënies, studentët e programit të studimit Bachelor në Punonjës Social, të Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar në FSHE, në datat 6 dhe 7 mars ndoqën me këshillim leksionet e pedagogëve italianë nga Universiteti i Barit, Roberta Santoro dhe Giuseppe Cascione. Bashkëpunimi me Universitetin e Barit, mbetet një nga pikat e forta për shkëmbimin e përvojave më të mira në këtë drejtim.



DITARI MUJOR

Mars 2023

Ditët e Informimit në Universitetin e Elbasanit



Në kuadër të "Ditëve të informimit", Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni me mbështetjen edhe të Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, zhvilloi në ambjentet e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", një cikël takimesh me shkollat e mesme publike dhe jopublike të Bashkisë Elbasan. Në këtë veprimtari të shtrirë në datat 2, 6, 9, 16, 23, 28 përfaqësues të personelit akademik dhe ndihmësakademik, përmes bisedave prezantuese dhe materialeve orientuese i njohën maturantët me programet e studimit, infrastrukturën dhe mundësitë e shumta që vihen në dispozicion për rrugëtimin e tyre akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Universiteti i Elbasanit, në kuadër të Këshillimit të Karrierës dhe Ditëve të Informimit të maturantëve, organizon çdo vit aktivitete promovuese dhe informuese.